1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i shërbimit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim (3 x 4X)</b>	
1.	Suport HPE Blades Chassis, Blade Servers, Storage System & Tape Library	1 vit			
2.	Suport IBM Storage System	1 vit			
3.	Suport CISCO Networking	1 vit			
4.	Suport HPE / Aruba Networking	1 vit			
5.	Suport BARRACUDA Networking	1 vit			
6.	Mirëmbajtje e infrastrukturës software	12 muaj			
				<b>Çmimi total</b>	_____



---

<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>	
<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 3.**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

---

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### **Shtojca 4.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

---


## **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

### **Nënshkrimi**

### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Me anë të kësaj procedure, UKT kërkon të prokurojë blerjen e garancive dhe licensave për mbështetje teknike të infrastrukturës qendrore ekzistuese me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në 99.9%, kjo në bazë të përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore" në të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara nga ky sistem.

Komponentët kryesorë të infrastrukturës janë:

#### 1. Infrastruktura Hardware

- i. HPE Blades Chassis & Servers
- ii. HP Storage
- iii. HPE Networking
- iv. IBM Storage

- v. CISCO Networking
- vi. BARRACUDA Networking

## 2. Infrastruktura Software

- i. Windows OS
- ii. Exchange Mail Server

Ne vijim, gjenden specifikimet teknike:

Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia
1	Suport HPE Blades Chassis, Blade Servers, Storage System & Tape Library	vit	1
2	Suport IBM Storage System	vit	1
3	Suport CISCO Networking	vit	1
4	Suport HPE / Aruba Networking	vit	1
5	Suport BARRACUDA Networking	vit	1
6	Mirëmbajtje e infrastrukturës software	muaj	12

## 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E SUPORTIT DHE MIRËMBAJTJES TË INFRASTRUKTURËS

### 1.1. Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes së Platformave Hardware

Duke u mbështetur në informacionin e dhënë më sipër kompania duhet të jetë e aftë të mirëmbajë këto pajisje me ndihmën e vetë prodhuesve.

#### 1.1.1. Niveli i kërkuar i suportit për Server & Storage & Backup

Përshkrimi i suportit që kërkohet për pajisjet Server dhe Storage që ndodhen të instaluar në infrastrukturën qendrore të UKT-se është si me poshtë:

Suporti përfshin pajisjet që ndodhen në infrastrukturën e UKT-së të cilat kanë pasur një suport 1 vjeçar, me kohën e përgjigjes brenda ditës së nesërme të punës, mbulim përgjatë orarit zyrtar të orëve të punës (intervali nga hëna në të premte gjatë orarit 9:00 - 17:00), shërbimin e ofruar në ambientet e klientit). Kërkohe të rinovohet suportit i këtyre pajisjeve Hardware nga shitësi i tyre për një kohezgjatje 1 (një) vjeçare, me kohe përgjigjeje brenda dites së nesërme të punës, mbulimin përgjatë orarit zyrtar (intervali 9:00 - 17:00 nga hëna në të premte), suportin dhe diagnostikimin në distance dhe po qe nevoja në ambientet e UKT,

---

zëvendësimin e pjesëve të difektuara, manaxhimin dhe përkallëzimin e thirrjeve dhe incidenteve, dhenien e aksesit në shërbimet dhe informacionet elektronike të shitësit, ndjekjen e problemit deri në zgjidhjen përfundimtare. Suporti dhe mirëmbajtja e infrastruktures Hardware duhet të ofrohet nga një kompani e autorizuar zyrtarisht nga Prodhuesi për ofrimin dhe kryerjen e këtyre shërbimeve në territorin e Shqipërisë. Operatori Ekonomik duhet të kryejë operacionet e mëposhtme të monitorimit, diagnostikimit, kontrollit, ndërhyrjes dhe dokumentimit të tyre, për të siguruar mbarëvajtjen e pajisjeve Servera, Storage dhe Backup dhe parandalimin në kohë të problemeve që mund të lindin në këto pajisje.

1. Verifikim në vend (fizik) i të gjitha pajisjeve (Servera Storage dhe Backup) për të identifikuar gjendjen e pajisjeve. Ky operacion do të kryhet brenda 1 (një) jave nga lidhja e kontratës dhe në përfundim të tij, Operatori Ekonomik do t'i dorëzojë UKT një raport të detajuar për të gjithë pajisjet.
2. Verifikim në distancë (lidhje remote) dhe nëse është e nevojshme në vend (fizik) i pajisjeve, për sinjale që njoftojnë degradimin/lindjen e problemeve në gjithë komponentët Hardware – monitorim mujor;
3. Verifikim logjik nëpërmjet monitorimit të logeve të pajisjes, për hyrje që paraprijnë degradimin e pjesshëm ose total të pajisjeve. Ky tip monitorimi do të kryhet nëpërmjet mbledhjes së logeve dhe analizimit të tyre në distancë dhe nëse është e nevojshme në vend – monitorim mujor;
4. Verifikim në distancë (lidhje remote) dhe nëse është e nevojshme në vend (fizik) i pajisjeve të backup për sinjale që njoftojnë degradimin/lindjen e problemeve në gjithë komponentët Hardware – monitorim mujor;
5. Monitorimi në distancë (lidhje remote) i performancës dhe përdorimit të burimeve për secilin server, sipas pozicionit funksional të tyre në infrastrukturë – monitorim mujor;
6. Monitorim në distancë (lidhje remote) i procesit të backupit në disk dhe kasetë, performancës së backupit dhe kapacitetit të disponueshëm në kasetë dhe disk - monitorim mujor.
7. Diagnostikim dhe riparim të çdo problemi që vërehet gjatë operacioneve të monitorimit – diagnostikim brenda 1 (një) dite pune;
8. Diagnostikim në kohë të çdo problemi që raportohet nga personeli TI i UKT, duke respektuar klasifikimin e shkallës së problemit – diagnostikim brenda 1 (një) dite pune;
9. Kontroll në distancë (lidhje remote) për të evidentuar Firmware/Patch-e të vëna në dispozicion tek prodhuesit HPE/IBM – kontroll mujor;
10. Ndërhyrje për të zgjidhur problemet e verifikuara gjatë monitorimit, diagnostikimit apo kontrollit rutinë;
11. Sigurimi i pjesëve të këmbimit (menjëhere pas diagnostikimit të tyre);
12. Zëvendësim i pjesëve të difektuara (menjëhere pas konfirmimit nga ana e UKT);
13. Përkallëzim të problemit tek prodhuesit HPE/IBM (menjëhere pasi nuk arrihet zgjidhja sipas procedurave standard);
14. Raportim i sugjerimeve të dhëna nga prodhuesit HPE/IBM dhe plani i implementimit të tyre;

15. Dokumentim i çdo riparimi të kryer dhe konfirmim nga ana e stafit të autorizuar të UKT;
16. Paraqitja e raporteve mujore të operacioneve të kryera – brenda 3 ditëve të para të punës të muajit pasardhës.
17. Operatori Ekonomik do jetë përgjegjës për mbulimin me suport zyrtar nga prodhuesi për të gjitha pajisjet Hardware për të gjitha produktet dhe sistemet sipas tabelave më poshtë, për periudhën një vjeçare:

### ***Pajisje dhe sisteme HPE***

Emërtimi	Sasia	Përshkrimi	Numri Serial	Lloji	Sasia	Lloji i suportit
Shasi Blade	1	HP BLc7000 CTO 3 IN LCD Plat Enclosure	CZ270309SJ	HW	1	Suport Foundation Care NBD nga prodhuesi HPE
Servera Blade	4	HPE BL460c G9 E5v4 10/20 Gb CTO Blade	CZ270309SD CZ270309SF CZ270309SG CZ270309SH	HW	4	Suport Foundation Care NBD nga prodhuesi HPE
Servera Blade	2	HPE BL460c Gen10 10/20 Gb FLB CTO Blade	CZ283207QV; CZ283207QW	HW	2	Suport Foundation Care NBD nga prodhuesi HPE
Switch SAN	2	Brocade 16Gb/16c Embedded SAN Switch	1CG651E02M; 1CG651E027	HW	2	Suport Foundation Care NBD nga prodhuesi HPE
Switch Ethernet	2	HP 6125XLG Blade Switch	6C76452049; 6C7645202D	HW	2	Suport Foundation Care NBD nga prodhuesi HPE
Sistem Storage për backup në disk	1	HP StoreOnce 2900 24 TB	CZ26031663	HW	1	Suport Foundation Care NBD nga prodhuesi HPE
Tape library FC	1	HP MSL2024 0-Drive Tape Library	DEC44705F3	HW	1	Suport Foundation Care NBD nga prodhuesi HPE

### ***Pajisje dhe sisteme IBM***

Emërtimi	Sasia	Komponentët	Numri Serial	Sasia	Lloji i suportit
Sistem Storage	1	IBM Storage V5030	781R331	1	Remote System Service Support
		IBM Storage Expansion for V5000	781P112	1	Remote System Service Support
		IBM Storage	781P114	1	Remote System Service Support

		Expansion for V5000			
		IBM V5000 SFF Expansion	781N752	1	Remote System Service Support

### **1.1.2. Niveli i kërkuar i suportit për Network & Security**

Gjatë realizimit të këtij shërbimi, Operatori Ekonomik i shpallur fitues do të jetë përgjegjës për infrastrukturën rrjetit dhe sigurisë mbi të cilën mbështeten shërbimet bazë dhe komunikimi në UKT. Për këto pajisje, operacionet e kërkuara nga Operatori Ekonomik janë:

1. Verifikim në vend (fizik) i të gjitha pajisjeve të rrjetit dhe sigurisë për të identifikuar gjendjen e pajisjeve në UKT. Ky operacion do të kryhet brenda 1 (një) jave nga lidhja e kontratës dhe në përfundim të tij, Operatori Ekonomik do t'i dorëzojë UKT një raport të detajuar për gjithë pajisjet;
2. Monitorimi i logeve që gjenerojnë pajisjet - monitorim mujor;
3. Riparimi i të gjitha problemeve që mund të lindin gjatë kohës që pajisjet janë në funksion;
4. Planifikimi i çdo ndërhyrjeje që do të kryhet në këto pajisje, me qëllim përmirësimin e shërbimit, apo shtime të konfigurimeve të reja, duke mbajtur, ndryshuar dhe zhvilluar dokumentacion të plotë për çdo veprim;
5. Zgjidhja e problemeve që lindin nga ndryshimi i aksesit në shërbimet e internetit/intranetit (në UKT dhe Degë), si rikonfigurime, testime, etj.;
6. Operatori Ekonomik duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me prodhuesin e pajisjeve për të përshkallëzuar çdo problem që nuk mund të zgjidhet nga stafi lokal; të kryejë hapjen dhe menaxhimin e case-ve të suportit deri në zgjidhjen përfundimtare të problemit.
7. Operatori Ekonomik do jetë përgjegjës për mbulimin me suport zyrtar nga prodhuesi për të gjitha pajisjet Hardware dhe rinovimin e të gjitha licensave përkatëse për të gjitha produktet dhe sistemet e rrjetit dhe sigurisë sipas tabelave më poshtë, për periudhën një vjeçare:

### ***Pajisje dhe sisteme Cisco***

Emërtimi	Sasia	Komponentët	Lloji	Sasia	Lloji i suportit/ licensës
Sistem next generation Firewall	2	ASA5525-FPWR-K9	HW	2	CISCO SMARTNET NBD
		L-ASA5525-TAMC	Licence	2	LICENCE PER ASA FPWR
Sistemi i sigurise se Email	1	ESA-C190-K9	HW	1	CISCO SMARTNET NBD
		ESA-ESI-LIC	Licence	400	LICENCA PER ESA
Switch Ethernet	4	WS-C2960X-48TS-L	HW	4	CISCO SMARTNET NBD

### ***Pajisje dhe sisteme HPE/ Aruba***



Emërtimi	Sasia	Komponentët	Lloji	Sasia	Lloji i suportit/ licensës
Router Core me Firewall dhe VPN	2	HPE MSR4060 Router Chassis	HW	2	Suport zyrtar nga prodhuesi HPE me NBD shipping
Router Branch me Firewall dhe VPN per degët kryesore	7	HPE MSR3044 Router	HW	7	Suport zyrtar nga prodhuesi HPE me NBD shipping
Router me Firewall dhe VPN për degë të vogla	16	HPE MSR3012 AC Router	HW	16	Suport zyrtar nga prodhuesi HPE me NBD shipping
Core Switch per HQ	2	HPE 5510 24G 4SFP+ HI Switch	HW	2	Suport zyrtar nga prodhuesi HPE me NBD shipping
Switch Aksesi per përdoruesit ne degët e medha	7	Aruba 2530 24G PoE+ Switch	HW	7	Suport zyrtar nga prodhuesi HPE me NBD shipping
Switch Aksesi per përdoruesit në degët e vogla	16	Aruba 2530 8G PoE+ Switch	HW	16	Suport zyrtar nga prodhuesi HPE me NBD shipping

### ***Pajisje dhe sisteme Barracuda***

Emërtimi	Sasia	Komponentët	Lloji	Sasia	Lloji i suportit/ licensës
SSL VPN & Remote Access Appliance	2	Barracuda NextGen Firewall F400 model F20	Hardware	2	
		Barracuda NGFW F400 model F20 1 Year EU	License	2	Engized Update License
		Barracuda NGFW F400 model F20 1 Year IR	Support	2	Instant replacement Support
		Barracuda NGFW F400 Model F20 1 Year Advanced Remote Access	License	2	Premium Remote Access License
Application Delivery Controller/ Load Balancer	2	Barracuda Load Balancer 640 ADC	Hardware	2	
		Barracuda Load Balancer 640 ADC 1 Year EU	License	2	Engized Update Licenses
		Barracuda Load Balancer 640 ADC 1 Year IR	Support	2	Instant replacement Support

## **1.2. Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes së Platformave Software**

Duke u mbështetur në informacionin e dhënë më sipër kompania duhet të jetë e aftë të mirëmbajë këto Software me ndihmën e vetë prodhuesve.

### ***1.2.1. Niveli i kërkuar i suportit për platformat Software***

Suporti i kërkuar për këtë Software duhet të jetë për një periudhë 1 (një) vjeçare, me kohë përgjigjeje brenda ditës së nesërme të punës, mbulimi përgjatë orarit zyrtar ( intervali 9:00 - 17:00 nga e hëna në të premte), shërbimin e ofruar në distance (lidhje remote) dhe nëse është e nevojshme në ambientet e UKT, suporti dhe diagnostikimi në distancë, ndiekjen e problemit deri në zgjidhjen përfundimtare.

---

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes mujore për produktet dhe platformat Microsoft. Shërbimet e ofruara duhet të përfshijnë operacionet e mëposhtme të organizuara sipas platformave.

### **1. Microsoft Windows Server 2016 Standard OS**

- Mirëmbajtje të roleve të instaluara në to;
- Mirëmbajtje të Hyper-V Cluster;
- Mirëmbajtje të replikimit të Domain Controller
- Përditësimi i Windows OS duke përdorur Windows Updates;

### **2. Microsoft Exchange Server 2016**

- Mirëmbajtje e dy serverave pjesë e Exchange Cluster;
- Mirëmbajtje dhe monitorim i Exchange 2016 DAG;
- Përditësim i Microsoft Exchange Server 2016 duke përdorur Windows Updates;
- Mirëmbajtje dhe monitorim i procesit të Backup-it.

Shërbimet e ofruara duhet të kategorizohen në dy lloje:

#### **a) Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese**

Kompania duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha platformat e listuara në tabelën mësipër. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen pranë UKT.

#### **b) Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e UKT)**

Kompania duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, gjatë orarit 9:00 - 17:00, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i UKT. Për këtë qëllim, me termin “Alarm Madhor” do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të Sistemeve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të proceseve të punës në UKT. Qëllimi i shërbimit të suport dhe mirëmbajtje të komponenteve të mesiperm është realizimi i proceseve të më poshtme:

1. Mirëmbajtjen dhe përditësimin (update) e këtyre sistemeve, në mënyrë që të garantohet stabiliteti dhe mos ndërprerja e shërbimit në asnjë rast.
2. Analizimin e “event log-eve” për çdo sistem dhe ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për të fiksuar problemet e mundshme.



---

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:**

**Afatet e ekzekutimit:**


---

**Shtojca 7**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

---

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

***Shënim:Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë UKT sh.a dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

***Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.***

***Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar i pari janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës janë krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe deklaratën për caktimin e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë***

---

---

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; 416,055.24 (katerqind e gjashtembedhete mije e pesedhete e pese pike njezet e kater )leke*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

---

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2023)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

2.2.4.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.



---

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

### **2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël 6.240.828.6 (gjashtë milion e dyqind e dyzet mijë e teteqind e njezet e tete pike gjashtë ) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një ) punonjës të certifikuar nga Prodhuesi HPE për pajisje Server.
- b. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një ) specialistë të certifikuar nga Prodhuesi IBM për pajisje Storage.
- c. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një ) punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Windows Server 2016.
- d. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Exchange Server 2016.
- e. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Microsoft Server Virtualisation.
- f. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Cisco për pajisje Rrjeti.
- g. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të certifikuar nga Prodhuesi HP për pajisje Rrjeti.
- h. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të certifikuar nga Prodhuesi BARRACUDA.

*Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.*

---

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a.Kontratën e punës

b.Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

c)Punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë muajin e fundit.

**Shënim:** Për plotësimin e pikave të mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë **ISO 9001:2015 “Për Manaxhimin e Cilësisë”** (e vlefshme), lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zerave që do të marrë persiper sipas akt-marreveshjes).

**2.4.2.** Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën **ISO 27001:2013 “Për Sigurinë e Informacionit”**, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zerave që do të marrë persiper sipas akt-marreveshjes)

**2.4.**Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi IBM i produkteve Storage apo distributori i autorizuar nga prodhuesi IBM i produkteve Storage.Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin IBM apo me distributorin e autorizuar nga prodhuesi IBM.

**2.4.5.**Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi HP i produkteve Server apo distributori i autorizuar nga prodhuesi HP i produkteve Server.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin HP apo me distributorin e autorizuar nga prodhuesi HP.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



## Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
